



RAPORT VJETOR

HANDIKOS

2024

PËRMBAJTJA

•	Parathënie.....	3
•	Përmbledhje ekzekutive.....	4
•	HYRJE.....	5,6
•	Projektet e implementuara përgjatë 2023	7
•	Shërbimet e ofruara përgjatë 2023.....	8
◦	Shërbimet ditore për fëmijë, prindër të rritur.....	9,10,11
◦	Shërbimet e pajisjeve ndihmëse.....	12
◦	Shërbime juridike dhe tjera.....	13
	Trajnime dhe punëtori.....	14-18
•	Intervenimet avokuese dhe lobuese/ Sfidat.....	19-27
	Publikime.....	28

PARATHËNIE

HANDIKOS është themeluar si një reagim ndaj kushteve të vështira me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Studimet tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesjes shoqërore është një element thelbësor i rolit të shtetit, dhe përfitimet që vijnë nga përkujdesja konsiderohen të drejta të individëve. Kjo qasje, e cila është themelore për suksesin ose dështimin në përkujdesjen ndaj personave me aftësi të kufizuara, ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e shoqërisë.

Sipas Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, gjendja aktuale e këtyre personave nuk përmbush realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Prandaj, të gjitha institucionet janë të detyruara të kontribuojnë në garantimin e këtyre të drejtave, duke eliminuar çdo pengesë dhe barrierë që ndikon në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kuadër, është e qartë se institucionet e Kosovës kanë ende shumë punë për të bërë dhe shumë përpjekje për të investuar.

HANDIKOS vazhdon të punojë për përmirësimin e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara, duke lobuar dhe avokuar për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për të gjithë.

Objektivat tona kryesore gjatë vitit 2024 përfshijnë:

-Avokimin dhe lobimin për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar përfshirjen e tyre në legjisllacionin e Kosovës;

-Vazhdimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, shërbime të cilat janë esenciale dhe të domosdoshme, por që ende mbeten një sfidë e madhe;

-Ngritjen e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara për të kuptuar të drejtat e tyre, si dhe trajnimin e stafit të HANDIKOS për t'i mbështetur ata në realizimin e këtyre të drejtave.

Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me shumë sfida dhe barrierë, përfshirë ato të qasjes, rehabilitimit institucional, edukimit, punësimit dhe respektimit të të drejtave të tyre, duke u bazuar në legjisllacionin e Kosovës dhe dokumentet ndërkombëtare. Sfida të tjera paraqiten për HANDIKOS, e cila mbështetet 100% në projekte, pa ndihmën e përhershme të institucioneve, sidomos në ofrimin e shërbimeve që ende nuk janë të disponueshme nga shteti.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë dhe duhet të kenë mundësinë të arrijnë pavarësinë e plotë, duke kontribuar përmes aftësive dhe talenteve të tyre në zhvillimin e shtetit tonë.

Afrim Maliqi

❖ PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor – 2024 paraqet një pasqyrë përmblendhëse të të arriturave të HANDIKOS përgjatë vitit, në kuadër të programeve të implementuara. Të dhënat e raportuara janë të bazuara në të arriturat e HANDIKOS-it në implementimin e projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe atyre të huaj. Përmes shërbimeve të ofruara përgjatë një viti për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe prindër/familjarë të tyre, HANDIKOS ka vazhduar misionin e saj për të avancuar situatën e aftësisë së kufizuar në vend.

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka ofruar shërbime direkte për 53 fëmijë me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës dhe 25 prindër të tyre. Njëkohësisht janë ofruar gati 800 pajisje ndihmëse për qytetarë nga e gjitha Kosova. Përmes këshillave ligjore, HANDIKOS ka ndikuar në përmbushje të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara. Përgjatë një (1) viti, 179 këshilla juridike janë ofruar për personat me aftësi të kufizuara në mbarë Kosovën, si dhe janë asistuar dhe mbështetur dy (2) padi shtesë për diskriminim në qasje, duke e çuar numrin në tetë (8) padi në total, përfshirë takime mbështetëse, referime, vizita në shtëpi, shërbime për jetesë të pavarur etj.

HANDIKOS ka vazhduar edhe këtë vit si prioritet lobimin dhe avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe kërkesat drejt institucioneve në rregullimin e shumë problematikave me të cilat përballen në përditshmëri. Angazhimi ynë ishte i fokusuar në avokimin për politika e veprime konkrete që do ndikonin në përmirësimin e jetesës së komunitetit tonë.

Bashkëpunimi i ngushtë që HANDIKOS ka vazhduar ta mbajë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet lokale dhe qendrore, shoqërinë, dhe vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka ndikuar dukshëm në funksionimin epërditshëm, adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe avancimin e situatës së tyre në shoqëri. HANDIKOS vazhdon të punojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara.

HYRJE

- HISTORIKU

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar më 1983, me iniciativën e z. Halit Ferizi, kryetar i atëhershëm i shoqatës dhe më vonë lider i lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë, së bashku me një grup të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Objektive kryesore ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë”, përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Prej themelimit e deri në ditët e sotme, HANDIKOS është përkrahur nga një numër i konsiderueshëm i organizatave ndërkombëtare dhe vendore të cilat i kanë mundësuar HANDIKOS ekzistencën për më shumë se dy (2) dekada. Në fillimet e saj, HANDIKOS mbështetje të madhe ka pranuar nga: “HandicapInternational”, “OXFAM”, Agjencia Finlandeze FIDIDA, Qeveria e Finlandës, Ambasada e Finlandës, Organizata Italiane “Onlus Wamba-Athena”, “Onlus Roberto Bazzoni”, “Save The Children”, “UNICEF”, Agjencia Evropiane për ndërtim dhe rindërtim, mbështetës të cilët kanë mundësuar misionin dhe vizionin e HANDIKOS.

Pavarësisht mungesës së statistikave vendore për numrin dhe prevalencën e aftësisë së kufizuar në vend, në databazën e saj, HANDIKOS numëron më shumë se 18,000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme në mbarë Kosovën. HANDIKOS ka ofruar shërbime sociale në komunitet dhe shtëpi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familjarët e tyre. Për më tepër, përgjatë gjithë kësaj përvoje, HANDIKOS është orientuar gjithashtu edhe në avokim dhe lobim për njohje dhe respektim të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë duke intervenuar në vetëdijen e shoqërisë si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

HANDIKOS ndërvite ka modeluar dhe ofruar sete të ndryshme të programeve rehabilituese të cilat kanë mbështetur gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend dhe familjet e tyre. Të gjitha këto, janë ofruar përmes programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - RBB, program ky të cilin HANDIKOS e ofron që nga viti 2002 në Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Pejë, Istog, Mitrovicë; në kuadër të të cilave, sete të shumta të shërbimeve dhe teknikave avokuese janë implementuar. Së fundmi HANDIKOS në kuadër të programit të RBB-së është duke modeluar qasjen bio-psiko-sociale në të gjitha shërbimet e saj, qasje kjo e cila sheh personin në qendër nga këndvështrime të ndryshme.

Me gjithë veprimet që janë ndërmarrë viteve të fundit, personat me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në të gjitha aspektet jetësore të cilat u pamundësojnë atyre realizimin e të drejtave njerëzore dhe një jetese të dinjitetshme siç është reflektuar edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në aktet e tjera ligjore të vendit.

Bazuar në hulumtimet e fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, konsiderohet se rreth 16 % e popullsisë së botës kanë të paktën një aftësi të kufizuar. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka rezultuar se në Kosovë jetojnë 337 mijë e 859 qytetarë me vështirësi afatgjate, apo 21.3 për qind e popullsisë së përgjithshme.

VIZIONI

Shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara .

MISIONI

Të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre .

❖ PROJEKTET QË HANDIKOS KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË 2024

- HANDIKOS për të drejtat e fëmijëve, në bashkëpunim me Save the Children dhe financuar nga SIDA Suedeze
- Shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre – mbështetur nga Komuna e Prishtinës
- Shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara – mbështetur nga Ministria e Drejtësisë
- Përmirësimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara – mbështetur nga UNMIK në Kosovë
- Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara përmes veprimeve mjedisore – mbështetur nga Zyra e Presidencës
- Ofrimi i hapësirës dhe mbështetjes për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Suharekë – mbështetur nga USAID Kosovë
- Aleanca në Fushën e Aftësisë së Kufizuar për Reforma Gjithëpërfshirëse në Rajon”, pjesë e programit Smart Balkans – Mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë

❖ SHËRBIMET E OFRUARA PËR FËMIJË, TË RRRITUR DHE PRINDËR

HANDIKOS përgjatë vitit 2024 ka vazhduar të ofrojë shërbime për fëmijët, prindërit/kujdestarët, të rriturit e qytetarët e tjerë.

Shërbimet për komunitetin janë ofruar duke u bazuar në modelet që HANDIKOS ka pilotuar dhe programuar ndër vite, duke ofruar kështu mbështetje holistike me bazë bio-psiko-sociale si dhe duke u orientuar në pavarësimin e mbështetjen e fëmijëve, prindërve të tyre e të rriturve me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS përgjatë implementimit të shërbimeve të ofruara në kuadër të Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, me mbështetje të projekteve që ka implementuar përgjatë vitit 2024, të financuara nga donatorët vendor dhe të huaj, ka arritur të mbështesë **53 fëmijë** me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës, përmes 1171 seancave individuale dhe **25 prindër** përmes 300 seancave psikologjike, si dhe **30** të rritur të përfshirë në aktivitete të ndryshme.

Shërbimet kyçe të ofruara përgjatë këtij viti kanë mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve me theks në shkathtësitë ditore, zhvillimin kognitiv, fizik dhe atë emocional.

Shërbimet sociale të ofruara përgjatë 2024-ës në HANDIKOS në qendër dhe terren janë:

- Psikologji
- Fizioterapi
- Seanca grupore javore

53 FËMIJË

- PSIKOLOGJI
- FIZIOTERAPI

(1171
seanca)

- ❖ Aktivitete rekreative: 15 fëmijë pjesëmarrës
- ❖ Këshilla për prindërit dhe familjarët;
- 25 prindër pjesëmarrës
- 300 seanca



HANDIKOS ka vazhduar vlerësimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi multidisiplinar i organizatës, duke vënë fëmijën në fokus si dhe duke analizuar perspektivën e prindërve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve (kur është aplikuar). Bazuar në rezultatet e vlerësimit, janë përpiluar plane individuale të intervenimit për çdo fëmijë përfitues, përderisa risikimi i tyre është bërë në baza tre (3) mujore duke aplikuar procesin e ri-vlerësimit në të gjitha fushat e zhvillimit.

Të dhënat nga vlerësimi bazë i fëmijëve dhe ato nga ri-vlerësimi i fundit i realizuar në dhjetor 2024, tregojnë rezultate të kënaqshme të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara përgjatë një (1) viti, pavarësisht sfidave me të cilat janë ballafaquar fëmijët përfitues, ofruesit e shërbimeve si dhe prindëritë përfshirë në këtë proces.

Në fund të vitit 2024, me mbështetje të UNICEF kemi filluar edhe me një formë të re të ofrimit të shërbimeve për fëmijët me vështirësi zhvillimore dhe aftësi të kufizuara, përmes së cilës synojmë mbështetjen e zhvillimit, aftësive dhe socializimit të fëmijëve të moshës 0-6 vjeç.

Përmes qasjes multidisiplinare, kemi nisur shërbimet e mbështetjes zhvillimore të fëmijëve të vegjël në pesë komuna të Kosovës, përfshirë Prishtinën, Drenasin, Gjilanin, Suharekën e Ferizajn.

Janë rreth 200 familje të identifikuar, të cilat do të përfitojnë nga këto shërbime, prej tyre 68 përfitues janë vetëm nga regjioni i Prishtinës.

E veçanta e këtyre shërbimeve është fuqizimi i familjes, si dhe ofrimi i shërbimeve në ambientet natyrore të fëmijës, siç është shtëpia, këndi i lojrave, apo kopshti.





-Momente nga seancat e shërbimeve sociale për fëmijët-

❖ **Mbështetja për të rriturit me aftësi të kufizuara**

Në kuadër të projektit ‘‘Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara përmes veprimeve mjedisore’’, përfitues kanë qenë deri në 30 anëtarë tanë, të cilët përmes trajnimeve e aktiviteteve të artit kanë ngritur kapacitetet e tyre.

Ndërkaq theks të veçantë kishte angazhimi i tyre në punëtorinë e rrobaqepësisë, me 600 çanta të ripërdorshme të qepura në atë periudhë.

Pjesëmarrës ishin nëpër evente të ndryshme, aktivitete e trajnime të tjera, të organizuara në kuadër të HANDIKOS, por edhe jashtë saj.

❖ **3 sesione informuese
(30 pjesëmarrës)**



❖ **600 çanta të
ripërdorshme të
qepura**



❖ **10 pjesëmarrës në
punëtorinë e artit**



❖ SHËRBIMET E PAJISJEVE NDIHMËSE

HANDIKOS ka vazhduar të mbështesë personat me aftësi të kufizuara në Kosovë edhe përmes ofrimit të pajisjeve ndihmëse për lëvizje, shërbim ky i cili ka mundësuar dhe kontribuar në pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, për më tepër ka kontribuar direkt edhe në përmbushjen e misionit tonë.

Përgjatë një viti, kemi arritu që në mënyrë direkte të mbështesim me **763 pajisje ndihmëse** personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarët e tjerë që kanë pasur nevojë nga e gjithë Kosova. Kryesisht, përgjatë këtij viti janë shpërndarë karroca standarde, karroca tualeti, karroca speciale, paterica dhe shëtitore.

Çdo përfitues, fillimisht është vlerësuar, përmes inventarëve vlerësues që HANDIKOS posedon, inventarë të cilët pasqyrojnë nevojat e personit për përdorimin e pajisjes ndihmëse, si dhe specifikacionet e llojit të pajisjes ndihmëse dhe përmasave të saj. Pajisja ndihmëse është montuar dhe përshtatur me nevojat e përdoruesit të saj, përderisa të njëjtit janë trajnuar në përdorimin e shëndetshëm të pajisjes ndihmëse, mirëmbajtjen e shëndetit përgjatë përdorimit të pajisjes ndihmëse e gjithashtu edhe mirëmbajtjen e vetë pajisjes.

2024

	Vajza	Djem	Gra	Burra
	42	37	377	307
Nen Total	79		575	
TOTAL	763			




SHËTITORE
PAMPERSË
PATERICA
KARROCA TOALETI
KARROCA SPECIALE



❖ SHËRBIME JURIDIKE DHE TË TJERA

HANDIKOS ka vazhduar të ofrojë shërbimin e këshillimit juridik për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend edhe përgjatë vitit 2024, të cilat janë kryesisht relevante me rastet e diskriminimit, mohimit të të drejtave bazë të njeriut dhe parregullsi të tjera të cilat kanë të bëjnë me vështirësitë e personave me aftësi të kufizuara në gëzimin e benefiteve të garantuara me Ligj, siç është vlerësimi jo i drejtë ndaj personave me status Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

HANDIKOS ka ofruar 179 këshilla juridike për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe familjarët e tyre, përfshirë në padi, takime mbështetëse, referime, vizita në shtëpi, shërbime për jetesë të pavarur etj.



❖ Trajnime dhe punëtori

HANDIKOS si çdoherë ka punuar ngushtë me komunitetin që përfaqëson në ngritjen e kapaciteteve në fusha të ndryshme, përfshirë këtu fëmijët, të rriturit, prindërit, si dhe organizatat e tjera partnere, me të cilat bashkërisht synohet të avancohet situata e personave me aftësi të kufizuara në vend.

Në kuadër të projekteve të ndryshme, kemi realizuar takime e punëtori me akterë relevantë të cilët kanë rol kyç në çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, të rriturit, organizata të personave me aftësi të kufizuara, organizata të tjera nga shoqëria civile, Qendra për Punë Sociale, shkolla etj.



Përgjatë vitit 2024, Grupi Avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara ‘‘Hëna’’ ka vazhduar në mënyrë aktive të punojë në fuqizim dhe ngritje të kapaciteteve të rreth 115 fëmijëve me aftësi të kufizuara në shtatë komuna të Kosovës; Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Drenas e Suharekë.

TRAJNIME

PUNËTORI

HARTIM I
DOKUMENTEVE

SESIONE
INFORMIMI



- ✓ Shënimi i Ditës së Tokës me fëmijët e Grupit Hëna
- ✓ Organizimi i trajnimit me fëmijët e Grupit Hëna “Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike”
- ✓ Organizimi i trajnimit me fëmijët e Grupit Hëna “Si të shprehemi në publik”

- ✓ Hartimi i Politikës për Sinjalizues
- ✓ Hartimi i dokumentit “Analizë mbi Perspektivën e Aftësisë së Kufizuar dhe Perspektivës Gjimore në Kosovë”
- ✓ Hartimi i politikës Anti-Korrupsion

- ✓ Përditësimi i Rregullores Financiare dhe të Prokurimit
- ✓ Hartimi i rregullores për vlerësimin e performancës së stafit
- ✓ Organizimi i trajnimit për stafin e HANDIKOS “Donor engagement and project proposal”



- ✓ Takime me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal dhe qendror
- ✓ Shënimi i Ditës së Mjedisit me fëmijët e Grupit Hëna
- ✓ Organizimi i trajnimit me fëmijët e Grupit Hëna “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”

- ✓ Organizimi i punëtorisë me fëmijët e Grupit Hëna “Vetqëndrueshmëria e Grupit Hëna”
- ✓ Organizimi i trajnimit me fëmijët e Grupit Hëna “Të drejtat e fëmijëve dhe barazia gjimore”
- ✓ Hartimi i manualit për emergjencë

- ✓ Hartimi i Strategjisë për ngritjen e fondeve
- ✓ Organizimi i kampanjës “Respektomi të drejtat” bashkë me fëmijët e Grupit Hëna



Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 115 fëmijë të G. A“ Hëna” nga 7 komuna në të cilat funksionon grupi (Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Drenas dhe Suharekë)

❖ Trajnime/Punëtori dhe aktivitete tjera për të rritur me aftësi të kufizuara dhe prindër

- Dy persona me aftësi të kufizuara kanë marrë asistencë ligjore nga studiot ligjore për të drejtat e tyre për pensionet, si dhe kanë bërë ankesa pranë institucioneve për rregullimin e qasjes në infrastrukturë.



- Në bashkëpunim me HANDIKOS-Ranillug u mbajt një takim informues me personat me aftësi të kufizuara nga komuniteti serb. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe informimi i qytetarëve për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

- U organizua kamp rehabilitimi
- Grupi Avokues i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara shënoi Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Takimi u mbajt me përfaqësues të Avokatit të Popullit.
- Në komunën e Mitrovicës së Veriut u mbajt një takim i përbashkët për shkëmbimin e përvojave dhe mësimëve.
- U organizua një punëtori dy ditore për forcimin e avokimit të HANDIKOS-it lokal me qëllim të avokimit në nivel lokal, në përputhje me të drejtat.

- Pjesëmarrja në konferencën rajonale e projektit DADIRR—organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF)—bashkë me përfaqësues të institucioneve kyçe nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, për të avancuar aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.

- Zhvillim i trajnimeve dhe pjesëmarrje në takime në nivel lokal e rajonal

- Zhvillim dhe publikim i videos vetëdijësuese “Qasja dhe pjesëmarrja publike”



Publikimi i raportit:

ANALIZA E PËRPUTSHMËRISË SË KUADRIT LIGJOR TË KOSOVËS ME KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

dhe

Raporti me REKOMANDIME



- Realizimi i konferencës “Avancimi i politikave për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë”, me pjesëmarrës nga institucionet qendrore



- Konferenca për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit “Analiza e Përputhshmërisë së Kuartit Ligjor të Kosovës me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, me pjesëmarrës përfaqësues institucionesh, nga Avokati i Popullit, përfaqësues të OPAK’ve dhe anëtarë tanë



- 85 prindër dhe kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë intervistuar me qëllim identifikimin e nevojave të tyre specifike.

• **Trajnimet:**

1. Mirëqenia Psiko-Sociale: Strategji dhe praktika për përmirësimin e cilësisë së jetës së përditshme për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
2. Mirëqenia Fizike dhe Pavarësia: Mbështetje për rritjen e jetesës së pavarur për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre.
3. Ngritja e Kapaciteteve: Informimi i prindërve për legjislacionin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

• **Aktivitetet sensibilizuese:**

Organizimi i një marsi sensibilizues, me fëmijë, prindër, institucione lokale dhe qytetarë të komunës së Suharekës.



❖ LOBIMI DHE AVOKIMI

HANDIKOS përgjatë vitit 2024 ka punuar në fushën e avokimit dhe lobimit për të avancuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në vend, e me theks të veçantë për të promovuar të drejtat e barabarta dhe jetë të dinjitetshme për të gjithë. Përgjatë një (1) viti, HANDIKOS përmes takimeve, komunikimit nëpërmjet mediave e fushatave direkte e virtuale ka adresuar të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara, qasjen, edukimin dhe pjesëmarrjen.

Si një ngjarje tashmë e përvjetshme, edhe këtë vit është shënuar 1 Marsi- Dita ndërkombëtare e përdoruesve të karrocës, e cila është karakterizuar me një aktivitet që për qëllim ka pasur thirrjen për përmirësim të qasjes infrastrukturore, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të institucionit të komunës së Prishtinës, me të cilët bashkërisht u kaluan pengesa në qasje, me qëllim të vetëdijësimit për veprim në zbatimin e të drejtave elementare të qytetarëve me aftësi të kufizuata .Ngjarja është përcjellur me mesazhe të cilat portretizojnë jetesën e përdoruesve të karrocës në Kosovë, me moton **“Sot lëvizim bashkë!”**. Ngjarja është ndjekur nga mediat dhe ka pasur edhe prezencë të qytetarëve të tjerë, dhe e gjithë kjo ka arritur një shikueshmëri prej mbi 50.000 njerëz nëpër rrjete sociale.





❖ Shënimi i 3 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara

Me rastin e shënimit të kësaj date shumë të rëndësishme, HANDIKOS në Qendrën e Resurseve ka mirëpritur për vizitë kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti, ku në mesin e dhjetërave pjesëmarrësve – personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, janë adresuar këkesat dhe nevojat emergjente që duhet të plotësohen karshi të drejtave të njeriut.



(Momente nga vizita e kryeministrit të Kosovës, z. Albin Kurti)

Përtej këtij aktiviteti, HANDIKOS në Qendrën e Resurseve me lokacion në Veternik ka organizuar edhe një event, kështu duke mbledhur fëmijë, prindër të tyre e anëtarë të rritur, por edhe përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore, për të prezantuar të arriturat e organizatës në fushën e avokimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, si dhe të shërbimeve sociale.



❖ 10 DHJETORI – SHËNIMI I DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

“Respektomi të drejtat” - Ky ishte mesazhi përmes të cilit lansuam kampanjën në sheshin e Prishtinës, bashkë me fëmijë nga grupi avokues “Hëna” ☾, kështu duke shpërndarë çanta dhe një udhëzues praktik për qytetarët, në cilin përshkruhen mbrojtja, garantimi dhe respektimi i të drejtave, sipas ligjeve dhe Konventës.

Një nga mesazhet kryesore të fushatës ishte nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive nga ana e institucioneve publike, për të siguruar që çdo fëmijë me aftësi të kufizuara të ketë mundësi të barabarta për arsimim, përkujdesje shëndetësore dhe pjesëmarrje në jetën sociale.

HANDIKOS dhe Grupi Hëna u bënë apel të gjitha palëve të angazhohen në krijimin e kushteve më të mira, duke ofruar mbështetje dhe mbrojtje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përpos këtij aktiviteti, fushata u zhvillua edhe online, përmes publikimit të posterave dhe një video vetëdijësuese.




SFIDAT E FËMIJËVE NË KARROCË - NGA SHTËPIA NË SHKOLLË



❖ HANDIKOS rol të madh edhe në aktivitetet avokuese tjera:

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", si ndërtesë e mbrojtur e trashëgimisë moderne por edhe ndërtesë e rëndësishme kulturore, është bërë e qasshme për të gjithë, në qershor të vitit 2024. Kjo falë iniciativës, avokimit dhe angazhimit të HANDIKOS.

Kjo u arrit përmes realizimit të projektit "Nuk ka trashëgimi kulturore pa ne" në partneritet me CHWB Kosova dhe HANDIKOS, financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



TË ARRITURAT NË LOBIM DHE AVOKIM

- ❑ Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Statusin dhe të drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik;
- ❑ Kontributi në rregulloren e re për procedurat dhe kriteret e vlerësimit dhe njohjes së statusit dhe të drejtave të personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë
- ❑ Kontributi dhe pjesëmarrja në zhvillimin e Strategjisë qeveritare dhe Planit të Veprimit për persona me aftësi të kufizuara;
- ❑ Shënime të ndryshme, sikurse 3 dhjetori, 1 qershori, 1 marsi etj;
- ❑ Ligji për Aftësim, Riaftësim profesional dhe Punësim të personave me aftësi të kufizuara, UA;



- ❑ Ngritja e kapaciteteve të stafit të shoqatave të HANDIKOS në: Avokim, Zhvillim organizativ, ofrim të shërbimeve, unifikimi i kartelave vlerësuese dhe takimi vjetor;
- ❑ Ngritja e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve, përmes trajnimeve;
- ❑ Ngritja e dy (2) padive per diskriminim (vazhdon si proces);
- ❑ Fuqizimi i grupit të fëmijëve HËNA;
- ❑ Udhëzimi Administrativ për pajisje ndihmëse - Vendimi dhe ndarja e buxhetit;



TË ARRITURAT NË AVOKIM DHE LOBIM

- Bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit;
- Bashkëpunimi dhe partneriteti me OPAK;
- Bashkëpunimi dhe partneriteti me Rrjetin e Organizatave për të Drejtat e Njeriut;
- Pjesëmarrja në grupe të ndryshme punuese;
- Avokimi për qasje në Komunën e Prishtinës;
- Avokimi për mbështetje të shërbimeve sociale,
- Pjesëmarrja në Këshillin për Persona me Aftësi të Kufizuara;
- Avokimi përmes mediave dhe rrjeteve sociale
- Kontributet në Raportin e Progresit të BE'së për Kosovën
- Amandamentimi i Kushtetutës për përfshirjen e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Realizim i hulumtimeve/raporteve, analizave
- Kontributi në raportin e Rrjetit të organizatave për të Drejtat e Njeriut;

SFIDAT AKTUALE

- Vlerësimi i personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nga komisionet vlerësuese;
- Ndryshimi i rregullores;
- Projekt Kodi doganor dhe i akcizave;
- Energjia elektrike;
- Ligji gjithëpërfshirës;
- UA për qasje;
- Padi të tjera;
- Qëndrueshmëria e shërbimeve sociale;

❖ PUBLIKIME

1. PLANI STRATEGJIK 2024–2028

Linku: <https://shorturl.at/AQp4X>

2. ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË SË KUADRITLIGJOR TË KOSOVËS ME KONVENTËN E KOMBEVETË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Linku: <https://shorturl.at/Z7cUy>

3. RAPORTI ME REKOMANDIME

Linku: <https://shorturl.at/aaMZz>

4. BULETINI I GRUPIT HËNA

Linku: <https://shorturl.at/95U1c>

5. DORACAKU “RESPEKTOMI TË DREJTAT!”

Linku: <https://tinyurl.com/3e6hw2a5>

6. UDHËZUES MBI VETQËNDRUESHMËRINË E GRUPIT HËNA

Linku: <https://tinyurl.com/49vhctkk>

7. DORACAKU PËR QASJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LOKALITETE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Linku: <https://tinyurl.com/2drnk4t>

8. RAPORT PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULTA NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Linku: <https://tinyurl.com/55ybnvbf>

9. POLITIKA ANTIKORRUPSION

Linku: <https://tinyurl.com/b47v6nuc>

10. RREGULLORE MBI PROCEDURËN E SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE NË HANDIKOS

Linku: <https://tinyurl.com/2wj58v9n>



Rr. "Nekibe Kelmendi", nr. 80, Prishtinë; Telefoni: +383 49 377 655

Email: handikos@handi-kos.org; Webfaqja: <http://handi-kos.org/>

